



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

**GJIMNAZI
SHKENCA NATYRORE**



Prishtinë, gusht 2008

Emri dhe mbiemri i nxënësit

Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t' u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t' i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t' u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t' ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.

Numri **1** (një) paraqet numrin e pyetjes në fletën e përgjigjeve

Përgjigja e saktë, në *Fletën e përgjigjeve*, duhet plotësuar në këtë mënyrë me laps të thjeshtë HB



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t' u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo me kujdes fragmentin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjeve!

Tregtar flamujsh**I**

-Posi... U ba Shqipnija. Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija! Ti i meçëm, përgjegje tue bërtitë në kupë të qiellës: Rrnoftë, po! e shpejt me porositë flamujt. Na shkyeju: rrnoftë! e ti shit, ban pare tue tregtue mbi ndiesit t'ona. Lojë e bukur, por s'të ka dalë...

II

Gaspër Tragaci lëshoi shtizën e u avit kërcnueshëm kah djali. Flamuri ra për tokë. Hilushi s'luejti vendit. Shikonte syt e ftohtë qi lëshojshin shkëndija idhnimi. Tregtari u ndal para tij.

-Mos me kenë hatri i mikses së moçme qi kam me shtëpen t'ande, dij un...

I riu i a priti:

Për hatër t'asaj miksije tash qes bejta me t'u shit flamujt.

Me za qi dridhej prej pezmit, tjetri i a këthei:

-Po, zati ti s'din veç me qitë bejta. Jeto me pralla, bieru mbas andrrave. Më vjen keq për gjind të tuej se tash i qet në rrugë të madhe, më shka shof un. Hajt, hajt qit bejta e dueje Shqipnin: bejttat e Shqipnija kanë me të qitë në dritë...

III

U afrue edhe ma tepër e pëshpëriti si në një fishkullimë:

-U shitne a s'u shitne flamujt, qëndroi a s'qëndroi Shqipnija, un kam mjaft, shyqyr, me jetue: a more vesht? e tash jashtë...

-Kadalë... – i a priti djaloshi me t'eger e syt i vetuen: dal vetë, s'asht nevoja me më qitë jashtë. Por edhe një fjalë due me t'a thanë e të lutem vire në vesh si at këshill qi më dhae par në dugajë. Ti thue se jeton, por rrelesh. Ti je shlye prej numrit të të gjallve qyshse je ndry në kët dugajë mbushë me mall. Ky asht vorri yt. E sa për Shqipni, po të siguroj un se ka me qindrue.

Ernest Koliqi

1. E folmja e narratorit në këtë fragment tregon se ngjarja ndodh më afër:

- A. Tiranës
- B. Shkodrës
- C. Elbasanit
- D. Prishtinës

2. Fjalja „e tash jashtë!” shpreh:

- A. urdhër
- B. dëshirë
- C. sugjerim
- D. çudi

3. Teksti i narratorit të jashtëm në këtë fragment argumentohet përmes:

- A. dialogut ndërmjet personazheve
- B. gjuhës së personazheve
- C. përshkrimit narrativ
- D. gjuhës së narratorit

4. Zëri i narratorit në këtë fragment del në fjalinë:
- E sa për Shqipni po të siguroj un se ka me qindrue
 - Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija
 - Për hatër t'asaj miksije tash qes bejta me t'u shit flamujt
 - U afrue edhe ma tepër e përshpëriti si në një fishkullimë
5. Informata themelore e fragmentit përmbledhet në fjalinë:
- Dalin të marrët e vikasin: Rrnoftë Shqipnija!
 - Na shkyeju: rrnoftë! e ti shit, ban pare tue tregtue mbi ndiesit t'ona
 - Po, zati ti s'din veç me qitë bejta. Jeto me pralla, bieru mbas andrrave
 - Për hatër t'asaj miksije tash qes bejta me t'u shit flamujt
6. Personazhi i drejtohet tjetrit: „*Ti thue se jeton po rrehash*”, sepse :
- jeton me gënjeshtër
 - jeton fshehurazi
 - vrapon pas fitimit
 - vrapon pas iluzioneve
7. Lidhëza „*por*”, në fjalinë: „*Por, edhe një fjalë due me t'a thanë e të lutem vire në vesh si atë këshill qi më dhae par në dugajë*”, mund të zëvendësohet me lidhëzën:
- prandaj
 - andaj
 - ndërsa
 - mirëpo
8. Fjalja: „*Me za qi dridhej prej pezmit, tjetri i a këthei*” në shqipen standarde bën:
- Me za qi dridhej prej pezmit, tjetri ia kthei
 - Me za që dridhej prej pezmit, tjetri ia këtheu
 - Me zë që dridhej nga pezmi, tjetri ia ktheu;
 - Me zë qi dridhej nga pezmi, tjetri ia këthei
9. Fraza „*vire në vesh* “ në paragrafin e tretë do të thotë:
- mbaje mend
 - vare në vesh
 - dëgjoje mirë
 - kuptoje drejt
10. Në fjalinë: „*Shikonte syt e ftoftë qi lëshojshin shkëndija idhnimi*”, figura e paradoksit ndërtohet ndërmjet gjymtyrëve:
- sytë dhe idhnimi
 - ftoftë dhe shkëndija
 - shikonte dhe lëshojshin
 - idhnimi dhe ftoftë
11. Forma „*u avit*” në paragrafin e dytë është folje në diatezën:
- veprore
 - vetvetore
 - mesore
 - pësore

Lexo me kujdes poezinë e mëposhtme dhe përgjigju pyetjeve!

ME JETUE

Erdhe në jetë
Nuk ka më nevojë për kuje lutje
Kryesorja të jetosh
Këtë gur ta hedhësh më lart se Unë

Prandaj

Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: i pari
Ai që ka ekzistuar para teje jam unë
Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama
Për ëndrrat e mia e qetësinë je Ti
Me pleh kurrë mos u pajto: Nxirre në gjysmë
të natës
në pikë të vapës
asgjë mos rrit, asgjë mos krijo me dhunë
rast i humbur nuk je edhe pse pylli
Dendësohet
Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar
Në botë
Dhe si të duash Ti Lumi
Kryesorja: Jetën ta jetosh pa e vrarë
Dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë
E saj e zezë
Bashkudhëtari im
Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë.

Ali Podrimja

12. Motivi i kësaj poezie është:

- A. erotik dhe meditativ
- B. meditativ dhe personal
- C. patriotik dhe filozofik
- D. social dhe përshkrues

13. Si formë poezia e dhënë mbështetet në:

- A. varg të rimuar
- B. varg të bardhë
- C. varg të dyzuar
- D. varg të lirë

14. Vargu: „Nuk ka më nevojë për kuje lutje” mund të interpretohet si:

- A. besim në jetë
- B. zhgënjim nga jeta
- C. nxitje për jetën
- D. lutje për jetën

15. Përfillja e këshillës së vargut: „*Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
Dhe kurrë mos mendo: i pari*”

pengon formimin e një personaliteti:

- A. narcisoid
- B. injorant
- C. të ndërgjegjshëm
- D. të papërgjegjshëm

16. Folja modale haset në vargun:

- A. Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë
- B. Dhe pa të mbetur në këmbë ndonjë therrë
- C. Me pleh kurrë mos u pajto, nxirre në gjysmë të natës
- D. Mund ta kalosh natën në Kullën time të vetmuar

17. Lidhëza „*derisa*” në vargun: „*Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë*”, mund të zëvendësohet me lidhëzën:

- A. mbasi
- B. teksa
- C. përderisa
- D. qëkurse

18. Gradacioni zbritës hetohet në vargjet:

- A. Ai që do të kujdeset për ditët e mia të mbrama je Ti
- B. Asgjë mos rrit, asgjë mos krijë me dhunë
- C. Sa më pak shikoje veten në pasqyrë
- D. Ta provojmë vetveten derisa të kemi frymë

19. Theksi logjik në vargun: „*Nuk ka nevojë më për kuje e lutje*” bie në fjalën apo togfjalëshin:

- A. më
- B. nuk ka nevojë
- C. për kuje
- D. e lutje

Lexo me kujdes paragrafin e mëposhtëm dhe përgjigju pyetjeve!

Problematiciteti shqiptar

Problemi ose Problematiciteti shqiptar... - Kemi trashëguar, thonë, një të shkuar kaotike; po kalojmë, thonë, një të tanishme kaotike: e ardhmja paraqitet si një zero matematike: "Shiko të shpëtosh kokën tënde!" - Këtë këngë vajtuese të këndojnë sot Pleq e të Rinj, dogmatikë e liberalë. Të ditur, të paditur, të gjithë njerëzit këtu brenda, i ka zënë një dobësi mistike, një lodhje morale dhe materiale. Dhe, si një rrjedhje e natyrshme e gjithë kësaj gjendjeje, një egoizëm vetjak, materialist, i lidhur ngusht me indiferencën, mërinë, ligësinë, dinakërinë më të përçmuar tejpërtej!. – Simptoma më tipike dhe me klasike të dekompozimit. Simptoma të dekadencës, që paraqitin popujt në mbrëmjen e historisë së tyre...
Ku gjendemi?

Branko Merxhani

- 20.** Forma e shkrimit si në fragmentin e dhënë më lart është tipike për:
- A. kritikën
 - B. poezinë
 - C. prozën
 - D. esenë
- 21.** Diskursi i përdorur në këtë fragment është:
- A. letrar - shkencor
 - B. eseistik - politik
 - C. letrar - artistik
 - D. gazetaresk - politik
- 22.** Në tekstin e dhënë, cilat janë simptomat e „*dekadencës, që paraqitin popujt në mbrëmjen e historisë së tyre...*”?
- A. e shkuara kaotike, e tanishmja kaotike, e ardhmja si zero matematike
 - B. të gjithë njerëzit, pleq e të rinj, këndojnë të njëjtën këngë vajtuese
 - C. egoizmi vetjak, materializmi, indiferenca, mëria, ligësia, dinakëria
 - D. të gjithë njerëzit, si dogmatikët dhe liberalët i ka zënë një dobësi mistike
- 23.** Titulli më i përshtatshëm për këtë tekst do të ishte:
- A. rrëmuja shqiptare
 - B. prishja morale
 - C. politika shqiptare
 - D. mbrëmja e historisë
- 24.** Sinonimi i fjalës „*egoist*” në shqip është:
- A. i pacipë
 - B. i pagdhendur
 - C. vetjak
 - D. keqberës
- 25.** Në strukturë të rregullt, sindetike të periudhës: „*Kemi trashëguar, thonë, një të shkuar kaotike; po kalojmë, thonë, një të tashme kaotike, e ardhmja na paraqitet si një zero matematike*” fitohet:
- A. periudhë me fjali të varur shkakore
 - B. periudhë me fjali të varur lejore
 - C. periudhë me fjali të varur kohore
 - D. periudhë me fjali të varur vendore

ENGLISH LANGUAGE

26. Tom owns Jack a large amount of money. Jack says he owns him exactly 11,875 Euros. Tom owns Jack _____.

- A. eleven thousand and eight hundred and seventy-five Euros
- B. eleven thousand and eight hundred seventy-five Euros
- C. eleven thousand, eight hundred and seventy-five Euros
- D. eleven thousand, eight hundred, seventy-five Euros

27. Samantha, John and Ricky are students. They have had six examinations so far. Below is the table with their examination scores taken from students' examination records.

Read the table carefully and choose the correct answer:

EXAMS	SAMANTHA	JOHN	RICKY
ENGLISH	10	9	6
LITERATURE	7	8	9
SPANISH	8	8	7
ARTS	9	10	6
MEDIA & COMMUNICATIONS	6	9	10
GENDER STUDIES	10	8	9
Average grade	8.33	8.66	7.83

- A. Ricky is as good as John in literature.
- B. John's got the highest score in arts.
- C. Samantha isn't the best student in English.
- D. Ricky's score in literature isn't the highest.

28. Read this text and then choose a sentence to complete the paragraph:

It was a cold winter evening and we were driving through the forest on an icy road. Suddenly the car stopped and we couldn't go on. We left the car on the road and decided to walk. We soon saw a house in the forest. We knew someone must be in since _____.

- A. the smoke was coming from the chimney
- B. everything was very quiet and peaceful
- C. we couldn't see anyone around
- D. there were no lights on in it

29. Choose the correct answer to complete the question:

I didn't sleep all night long. The wind blew and I felt very _____.

- A. uncomfortably
- B. uncomfortable
- C. much comfortable
- D. non-comfortable

30. Choose a word to complete the following sentence:

I wanted to give a big party at a restaurant in the outskirts of the city. The manager told me that he had to _____ additional staff if I wanted to have a real successful party.

- A. beg
- B. invite
- C. ask
- D. hire

31. Look at the following nouns. One of them DOES NOT exist. Which one?

- A. organization
- B. celebration
- C. realation
- D. collation

32. Choose the correct sentence:

- A. I had expected to find him at home as usual.
- B. I expected to had find him at home as usual.
- C. I had expected to find him as usual at home.
- D. I expected to had find him as usual at home.

33. Look at the words in the box and choose which sentence below is correct:

presents – could – the – see – not – children – wait – to - their

- A. The presents could not wait to see their children.
- B. The children not could wait to see their presents.
- C. The children could not wait to see their presents.
- D. The children could not see to wait their presents.

34. In this group of words three words have similar meaning except one.

Choose one word that is NOT similar to other three.

- A. receive
- B. give
- C. take
- D. accept

35. You go into a shop and you are not sure whether you want to buy something or not. If the shop assistant asks you, 'Can I help you?' from the following expressions:

1. I'm just browsing.
2. I'm just surfing.
3. I'm just viewing.
4. I'm just shop-lifting.

you should say '**I'm just browsing**' because _____.

- A. you are just checking
- B. you are just observing
- C. you are just bargaining
- D. you are just looking

36. The word **float** does **NOT** rhyme with only one of these words. Which one?

- A. antidote
- B. toast
- C. taught
- D. remote

37. In the string of words: **badly, lovely, smoothly, roughly, brilliantly**, the word **lovely** is different because _____.

- A. it is an adverb
- B. it is an adjective
- C. it ends in 'ly'
- D. it begins in 'l'

38. Read the paragraph carefully:

The big challenge facing scientists trying to rid mankind of the misery of common flu is finding a drug that can combat the huge and ever-changing variety of cold viruses. Researchers are looking for features that all such viruses share. **Whichever drug company comes up with something is guaranteed to make a fortune.**

Look at the highlighted text and complete the following sentence:

The author _____.

- A. is positive that the company will make a lot of money
- B. supposes the company will make a lot of money
- C. thinks that the company will make a lot of money
- D. hopes that the company will make a lot of money

39. Read the following sentences carefully:

1. I believe this is what life-long learning is about.
2. However, he always said he learnt a lot from us, the youngsters.
3. Always calm and understanding, he served as a mentor to many of us.
4. My grandfather was a really remarkable person.
5. We never made big decisions without having turned to him.

The correct order of sentences to form a paragraph is _____.

- A. 1 4 5 3 2
- B. 4 5 3 1 2
- C. 4 3 5 2 1
- D. 5 4 2 1 3


40. There are only two countries in the world in which drivers drive on the left side of the road. One of these countries is Japan, whereas the other is _____.

- A. Portugal
- B. South Africa
- C. Gambia
- D. Great Britain

MATEMATIKË

41. Është dhënë figura. Cila nga shprehjet vijuese paraqet syprinën e pjesës së hijezuar të figurës?

- A. $af - \frac{1}{2}ab$
- B. $ab + \frac{1}{2}ac$
- C. $\frac{1}{2}(af + ab)$
- D. $\frac{1}{2}(af - ab)$



42. Një trup është hedhur nga lartësia prej 250 m. Gjatë sekondës së parë ai zbrit për 15 m, gjatë sekondës së dytë 25 m, gjatë sekondës së tretë 35 m e kështu me radhë. Kur do të bjerë trupi në tokë?


- A. për më pak se 6 sek.
- B. ndërmjet sekondës së 6 dhe 7
- C. ndërmjet sekondës 7 dhe 8
- D. pas sekondës së 8

43. Cila është pikë e përbashkët e funksioneve $y = x^2 - x$ dhe $y = 1 - x$?

- A. (0, 0)
- B. (0, 1)
- C. (1, 0)
- D. (1, 1)

44. Është katërkëndëshi ABCD. Cili ekuacion kuadratik përcakton vlerën e x -it sipas të dhënave në figurë ?

- A. $x^2 + 16x = 0$
- B. $x^2 - 16x = 0$
- C. $x^2 - 20x + 16 = 0$
- D. $x^2 + 20x + 16 = 0$



45. Në qoftë se vlen: $a^2 - b^2 = 117$ dhe $a + b = 3$. Atëherë sa është vlera e shprehjes $a - b$?

- A. 31
- B. 33
- C. 36
- D. 39

46. Sa është vlera shprehjes numerike komplekse: $A = (\sqrt{1-i})^4$, ku $i^2 = -1$?

- A. $A = -2i$
- B. $A = 1 - 2i$
- C. $A = 1$
- D. $A = -i$

47. Në një bufe ndodhen 50 mysafirë, prej të cilëve 32 pinë kafe, 24 pinë ujë, kurse 12 pinë edhe kafe edhe ujë. Sa prej tyre nuk pinë as kafe e as ujë ?

- A. 0
- B. 1
- C. 6
- D. 8


48. Në një kompani janë tri grupe punëtorësh që marrin të ardhura sipas kualifikimeve, siç është paraqitur në tabelë. Sa janë përafërsisht të ardhurat mesatare ?

- A. 260 €
- B. 262.85 €
- C. 263.95 €
- D. 263 €

Grupi	Numri i punëtorëve	Të ardhurat
I	20	240€
II	10	280 €
II	5	320€

49. Është dhënë katrori ABCD (shih figurën) i cili rrotullohet për 450° me qendrën e rrotullimit në pikën e prerjes së diagonaleve të tij. Cili përkëmbim i përgjigjet këtij rrotullimi ?

- A. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ B & C & D & A \end{pmatrix}$
- B. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ C & D & A & B \end{pmatrix}$
- C. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ D & A & B & C \end{pmatrix}$
- D. $f \begin{pmatrix} A & B & C & D \\ A & B & C & D \end{pmatrix}$



50. Cila shprehje numerike i përgjigjet fjalisë:

“Prodhimi i shumës së numrave 0.6 dhe 0.4 me diferencën e tyre i rritur për 0.64” ?

- A. 0.82
- B. 0.84
- C. 1.12
- D. 1.14

51. Me cilën shprehje është ekuivalente shprehja $(\sqrt{3} \cdot 2^{-1})^2$?


- A. $\frac{2}{3}$
- B. $\frac{3}{2}$
- C. $\frac{3}{4}$
- D. $\frac{4}{3}$

52. Në qoftë se $\log_2 x = 3$ dhe $\log_3 y = 4$ atëherë sa është vlera e $\frac{y}{x}$?

- A. $\frac{81}{8}$
- B. $\frac{8}{81}$
- C. $\frac{8}{9}$
- D. $\frac{64}{81}$

53. Në trekëndëshin kënddrejtë njëri kënd i ngushtë është $\beta = 60^\circ$ dhe njëri katet është $a = 8 \text{ cm}$. Sa është kateti tjetër ?

- A. 4 cm
- B. 8 cm
- C. $4\sqrt{3} \text{ cm}$
- D. $8\sqrt{3} \text{ cm}$



54. Në një mbrëmje shoqërore marrin pjesë 32 nxënës të drejtimit shoqëror, 24 të drejtimit natyror dhe 26 të drejtimit matematikor. Nga salla nxirret rastësisht një nxënës. Sa është probabiliteti $P(x)$ që nxënësi i nxjerrë të jetë i drejtimit shoqëror ?

- A. $0.1 < P(x) < 0.2$
- B. $0.2 < P(x) < 0.3$
- C. $0.3 < P(x) < 0.4$
- D. $0.4 < P(x) < 0.5$

55. Janë dhënë tre termat e parë të vargut gjeometrik: x , 12, 48. Sa është vlera e x ?

- A. 2
- B. 3
- C. 4
- D. 6

56. Sa është vlera e $\lim_{x \rightarrow 2} \frac{x^2 - 5x + 6}{x - 2}$?

- A. -1
- B. 0
- C. +1
- D. ∞

57. Është dhënë ekuacioni i rrethit: $x^2 + y^2 + 4x - 6y + 12 = 0$. Cila pikë është qendra e rrethit ?

- A. $Q(2, 3)$
- B. $Q(-2, 3)$
- C. $Q(2, -3)$
- D. $Q(-2, -3)$

58. Është dhënë funksioni $f(x) = 2x \ln x$. Sa është $f'(1)$?

- A. 0
- B. 1
- C. 2
- D. 4

59. Cila është zgjidhja e integralit $I = \int \sqrt{1+x} \, dx$?

- A. $I = \frac{2}{3}(\sqrt{1+x})^3 + c$
- B. $I = \frac{3}{2}(\sqrt{1+x})^3 + c$
- C. $I = \frac{2}{3}(1+x) + c$
- D. $I = \frac{3}{2}(1+x) + c$

60. Cili është ekuacioni i drejtëzës e cila kalon nëpër pikat $M(1,1)$ dhe është normal me drejtëzën $y = 2x + 1$?

- A. $x - 2y - 3 = 0$
- B. $x + 2y + 3 = 0$
- C. $x - 2y + 3 = 0$
- D. $x + 2y - 3 = 0$

FIZIKË

61. Në grupin e rrezeve radioaktive bëjnë pjesë:

- A. rrezet ultravjollce
- B. rrezet rëntgen
- C. rrezet alfa
- D. rrezet infra të kuqe

62. Nëse shpejtësia e trupit rritet dy herë dhe distanca e trupit nga boshti i rrotullimit rritet dy herë, nxitimi radial i këtij trupi ($a_r = \frac{v^2}{r}$) do të:

- A. zvogëlohet katër herë
- B. rritet katër herë
- C. zvogëlohet dy herë
- D. rritet dy herë

63. Lëngjet janë gjendje agregate të cilat kanë:

- A. vetëm vëllim të caktuar
- B. vetëm formë të caktuar
- C. formë dhe vëllim të caktuar
- D. formë dhe vëllim të pacaktuar


64. Konstantja e zbërthimit radioaktiv llogaritet me shprehjen:

- A. $\lambda = \frac{0,693}{T}$
- B. $\lambda = \frac{T_{\frac{1}{2}}}{0,693}$
- C. $\lambda = \frac{0,693}{T_{\frac{1}{2}}}$
- D. $\lambda = \frac{0,693}{2T_{\frac{1}{2}}}$

65. Gjatë punës së një aparati elektrik brenda një muaji kemi paguar 10 euro. Çmimi i 1kwh kushton 0,20 euro. Sa kilovat energji elektrike janë shpenzuar brenda kësaj kohe?


- A. 50 kw
- B. 100 kw
- C. 150 kw
- D. 40 kw

66. Katër balona me madhësi të njëjtë lëshohen nga e njëjta lartësi që të bien në dërrasa që kanë numër të ndryshëm të gozhdëve (shih.fig.). Në cilin prej këtyre rasteve (shih.fig.) në balon bëhet presion më i vogël?



- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

67. Fushën magnetike e formon një magnet. Vijat e fushës magnetike dalin nga njëri pol dhe hyjnë në polin tjetër. Në cilën figurë janë të paraqitura në mënyrë të rregullt vijat e fushës magnetike (shih.fig.)?



- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV


68. Uji në lartësi të ulëta bregdetare valon në temperaturë më të lartë, për shkak se:

- A. në lartësi të vogla bregdetare temperatura e ajrit është më e ulët
- B. në lartësi të vogla bregdetare temperatura e ajrit është më e lartë
- C. me zvogëlimin e lartësisë mbidetare, shtypja atmosferike zvogëlohet
- D. me zvogëlimin e lartësisë mbidetare, shtypja atmosferike rritet

69. Sa duhet të jetë vlera e lartësisë prej të cilës bie trupi me masë $m = 10\text{kg}$ në tokë nëse energjia potenciale e tij është $E_p = 500\text{J}$ dhe vlera e nxitimit të tij


është $g = 10 \frac{m}{s^2}$ (shih.fig.) ?

- A. $h = 5\text{ m}$
- B. $h = 8\text{ m}$
- C. $h = 10\text{ m}$
- D. $h = 20\text{ m}$



70. Toka gjatë lëvizjes rreth Diellit e ndryshon shpejtësinë varësisht nga distanca me Diellin. Në cilin nga muajt e vitit të paraqitur në figurë toka e ka shpejtësinë më të vogël?

- A. Mars
- B. Qershor
- C. Shtator
- D. Dhjetor




71. Gjatë kalimit të dritës nga vakuumi në ujë rrezet e dritës thyhen. Cila nga formulat e mëposhtme paraqet shpejtësinë e rrezeve të dritës në ujë?

- A. $v = n \cdot c$
- B. $v = \frac{n}{c}$
- C. $v = \frac{c}{n}$
- D. $v = 2c \cdot n$


72. Lëngu rrjedh nëpër gypin me seksione $S_1 = 5\text{cm}^2$ dhe $S_2 = 10\text{cm}^2$. Shpejtësia e lëngut në seksionin e dytë është $v_2 = 5 \frac{m}{s}$, sa duhet të jetë shpejtësia e lëngut në seksionin e parë (shih.fig.)?

- A. $v_1 = 10 \frac{m}{s}$
- B. $v_1 = 15 \frac{m}{s}$
- C. $v_1 = 20 \frac{m}{s}$
- D. $v_1 = 25 \frac{m}{s}$



73. Një gyp cilindrik është i mbushur me gaz dhe vëllimi i gazit mbahet i pandryshueshëm (const.). Me nxehjen e gazit me një qiri (shih. fig.) temperatura e gazit do të rritet dy herë, çfarë do të ndodh në këtë rast me shtypjen e gazit në manometër ?

- A. Zvogëlohet katër herë
- B. Rritet katër herë
- C. Zvogëlohet dy herë
- D. Rritet dy herë



74. Nëse në strukturën e një gjysmëpërçuesi vendoset një element pesëvalent, sinjalin elektrik e bartin:

- A. jonet pozitive
- B. jonet negative
- C. elektronet negative
- D. vrimat pozitive

KIMI

75. Elementet e grupit të 1-rë të sistemit periodik të elementeve quhen:

- A. elemente halogjene
- B. elemente kalkogjene
- C. metale alkaline
- D. metale alkalino-tokësore


76. Në çfarë intervali sillet vlera pH në tretësirat e bazave ?

- A. Prej 1 deri në 14
- B. Prej 1 deri në 7
- C. Prej 3 deri në 7
- D. Prej 7 deri në 14

77. Sa është përqendrimi sasior i tretësirës së hidrosidit të kaliumit, nëse 5,6g KOH janë të tretur në 500 cm³ të kësaj tretësire ? Mr(KOH) = 56.

- A. C = 0.1 mol.dm⁻³
- B. C = 0.2 mol.dm⁻³
- C. C = 0.4 mol.dm⁻³
- D. C = 0.5 mol.dm⁻³

78. Cili komponim përftohet me oksidim të propanol-2 ?



- A. Propanoni
- B. Propani
- C. Propanali
- D. Propeni

79. Acidi nitrik është një nga acidet më të forta inorganike i cili në disa reaksione tregon veti oksiduese. Në cilin prej reaksioneve vijuese acidi nitrik vepron si mjet oksidues?

- A. $2\text{HNO}_3 + \text{CaCO}_3 = \text{Ca}(\text{NO}_3)_2 + \text{CO}_2 + \text{H}_2\text{O}$
- B. $2\text{HNO}_3 + \text{Ca}(\text{OH})_2 = \text{Ca}(\text{NO}_3)_2 + 2\text{H}_2\text{O}$
- C. $2\text{HNO}_3 + \text{BaCO}_3 = \text{Ba}(\text{NO}_3)_2 + \text{CO}_2 + \text{H}$
- D. $8\text{HNO}_3 + 3\text{Cu} = 3\text{Cu}(\text{NO}_3)_2 + 2\text{NO} + 4\text{H}_2\text{O}$

80. Cilat prej këtyre vetive janë karakteristike për komponime inorganike?

- A. Janë komponime kovalente, nuk digjen, janë joelektrolitë, zhvillojnë reaksione të shpejta
- B. Janë komponime kovalente, digjen, janë elektrolitë, zhvillojnë reaksione të ngadalshme
- C. Janë komponime jonike, nuk digjen, janë elektrolitë, zhvillojnë reaksione të shpejta
- D. Janë komponime jonike, digjen, janë joelektrolitë, zhvillojnë reaksione të shpejta

81. Cilat komponime kimike formohen nëse në acide karboksilike grupi OH zëvendësohet me grup amin?

- A. Amidet
- B. Esteret
- C. Halogjenuret e acideve
- D. Anhidruret e acideve

82. Sa është përqindja e karbonit në anilinë ($\text{C}_6\text{H}_5\text{NH}_2$)?

($\text{Ar}_{(\text{C})}=12$, $\text{Ar}_{(\text{H})}=1$, $\text{Ar}_{(\text{N})}=14$)

- A. 70%
- B. 77%
- C. 80%
- D. 87%

83. Është dhënë barazimi i reaksionit të zinkut me acid klorhidrik, me ç'rast përftohet kloruri i zinkut dhe lirohet hidrogjeni:



Në cilin rast është shënuar në mënyrë të saktë lloji i substancës, lloji i ndryshimit dhe lloji i produktit që përftohet?

	Zinku (Zn)	Oksidimi	Klorurii i zinkut (ZnCl_2)
I	Element kimik	Ndryshim fizik	Element kimik
II	Element kimik	Ndryshim kimik	Komponim kimik
III	Komponim kimik	Ndryshim fizik	Komponim kimik
IV	Komponim kimik	Ndryshim kimik	Element kimik

- A. I
- B. II
- C. III
- D. IV

84. Radiumi atomik i elementeve në kuadër të periodës së njëjtë të sistemit periodik zvogëlohet me rritjen e numrit atomik të tyre. Pse ndodh kjo?


- A. sepse rritet numri i elektroneve në të njëjtin nivel
- B. sepse zvogëlohet numri i elektroneve në të njëjtin nivel
- C. sepse rritet numri i niveleve energjetike
- D. sepse zvogëlohet numri i niveleve energjetike

85. Cilat grimca subelementare e përbëjnë izotopin ${}^{19}\text{F}$?

- A. 19 protone, 9 neutrone dhe 9 elektrone
- B. 9 protone, 19 neutrone dhe 19 elektrone
- C. 9 protone, 10 neutrone dhe 9 elektrone
- D. 10 protone, 9 neutrone dhe 10 elektrone

86. Në cilin rast është dhënë emri i saktë sipas nomenklaturës IUPAC për komponimin e dhënë?

- A. Etil-4-metil-2-heksan
- B. Metil-4-etil-2-heksan
- C. Etil-2-metil-4-heksan
- D. Metil-3-etil-2-heksan



87. Çfarë lloj komponimesh janë sapunet?

- A. Trigliceride
- B. Detergjente
- C. Kripëra të acidit acetik
- D. Kripëra të acideve të larta yndyrore

BIOLOGJI

88. Te shpendët janë të zhvilluara llojet e ndryshme të këmbëve të cilat kanë funksione të ndryshme. Këmba e paraqitur në figurën e mëposhtme shpendëve u shërben:

- A. për lundrim
- B. për grabitje
- C. për fluturim
- D. për zvarritje



89. Në këtë fotografi është paraqitur Ciklopsi. Në cilin grup sistematik të shtazëve bën pjesë ky organizëm?

- A. Gaforre
- B. Insekte
- C. Merimanga
- D. Rriqra



90. Delja në një livadh ushqehet me bimët e livadhit ndërsa ujku ushqehet me delen. Në cilën kategori trofike bën pjesë ujku në këtë zinxhir ushqimor?

- A. Konsumues dytësor omnivor
- B. Konsumues parësor bimëngrënës
- C. Konsumues dytësor mishngrënës
- D. Konsumues terciar mishngrënës



91. Sëmundjet trashëguese te njeriu (kromozomopatitë) janë pasojë e ndërrimeve strukturore dhe numerike të kromozomeve. Nëse paraqitet monosomia e një kromozomi seksual (45, XO), shfaqet sëmundja gjenetike e njohur si sindromi i:

- A. Klinefelterit
- B. Daunit
- C. Pataut
- D. Turnerit

92. Në këtë figurë janë paraqitur katër lloje të sistemit nervor. Cilit lloj të sistemit nervor i takon sistemi nervor i bretkosës?

- A. ganglioz
- B. gypor
- C. pejzor
- D. rrjetor



93. Etapat e krijimit të qelizave vezë gjatë procesit të ovogjenezës zhvillohen sipas kësaj renditje:

- A. ovociti sekondar → ovogonia → ovociti primar → qeliza vezë
- B. qeliza vezë → ovociti primar → ovociti sekondar → ovogonia
- C. qeliza vezë → ovociti primar → ovogonia → ovociti sekondar
- D. ovociti primar → ovociti sekondar → ovogonia → qeliza vezë

94. Mutacionet janë ndryshime gjenetike në kromozome, që mund të jenë ndryshime në numrin dhe strukturën e kromozomeve. Ndryshimet kromozomale në figurën e mëposhtme i takojnë:


- A. inversioneve
- B. translokacioneve
- C. aneuploidisë dhe poliploidisë
- D. duplikacioneve dhe delecioneve

95. Si quhen organizmat që ushqehen vetëm me mish?


- A. Autotrofë
- B. Herbivorë
- C. Karnivorë
- D. Omnivorë

96. Në figurë shihet cikli i zhvillimit të një paraziti, që mund të infektojë edhe njeriun. Për ciklin e zhvillimit të cilit lloj parazitar bëhet fjalë në këtë foto?

- A. Cikli i zhvillimit të shiritit
- B. Cikli i zhvillimit të trikinës
- C. Cikli i zhvillimit të askarisit
- D. Cikli i zhvillimit të këlbazës



97. Në bazë të të dhënave në diagramin e paraqitur, ju duhet të gjeni se për cilin proces oksidues është fjala:



- A. Cikli i Krebsit
- B. Cikli pentozik
- C. glukoneogjeneza
- D. glukogjeneza

98. Përveç rolit mbështetës dhe lëvizës, eshtrat kryejnë edhe këtë funksion:

- A. Prodhojnë qeliza të gjakut
- B. Rrisin sasinë e hormoneve në gjak
- C. Ekskretojnë produkte të metabolizmit
- D. Sekretojnë materie jargore

99. Në këtë fotografi është paraqitur kanguri. Cilat janë organet e frymëmarrjes te kjo shtazë?

- A. Lëkura
- B. Verzat
- C. Mushkëritë
- D. Traketë



100. Lineu është natyralisti i parë që përdori:

- A. mikroskopin optik
- B. termin trashëgimi
- C. termin ekologji
- D. nomenklaturën binare